



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1401/2 Prot.

Tiranë, më 20/11/2020

V E N D I M (QARKULLUES)

Nr. 27 datë 20.11.2020

PËR

**MIRATIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E KËRKUARA NGA MINISTRIA E
INFRASTRUKTURËS DHE EKONOMISË**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 105, Vendimin nr. 188, datë 13.03.2019 “Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë, të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre”, pika 2 dhe 3, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe mbështetur në relacionin nr. 1401/1 prot, datë 17.11.2020 të Administratorit të Institucionit;

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat për shërbimet e kërkuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Ekonomisë, sipas mesatares së vlerave të tregut, për shërbimet si më poshtë:
 - “Hartimi i një projekti për zonat industriale” - 999 960 (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë me tvsh;
 - “Hartimi i studimit tekniko – ekonomik për industrinë mekanike” - 999 950 (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pasëdhjetë) lekë me tvsh;
 - “Hartimi i Anekseve Kombëtare të Eurokodeve” - 3 000 000 (tre milion) lekë me tvsh.